

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit - Nr. i AP: **NPL KASTRIOTI -26-1034-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me materiale elektrik për nevoja të ndërmarrjes-Ri-tender**

A N K E S Ë

Identifikimi i ankuesit*

OE “Item EL SH.P.K.”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. “Burim Vitia” p.n.

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+383 49497382

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Ahmet Vitia

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

itemshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

24.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **“Furnizim me materiale elektrik për nevoja të ndërmarrjes-Ri-tender”**.

Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është bërë më datë 06.03.2026

Dorëzimi dhe hapja e tenderëve është bërë me datë 16.03.2026.

Me datë 10.04.2026 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 15.04.2026 jemi drejtuar me Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK me datë 16.04.2026 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim me datë 20.04.2026 iu kemi drejtuar OSHP-se me ankesë.

OSHP me datë 10.06.2026 e ka publikuar vendimin lidhur me ankesën tonë ku lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të tenderëve, AK me datë 05.08.2026 e ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së andaj të pakënaqur me këtë vendim me datë 10.08.2026 iu kemi

drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me date 13.08.2026 e ka refuzua kërkesën tonë andaj te pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohor po i drejtohem OSHP-se me këtë ankesë.

Kriteri i vlerësimit ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët me poentim.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja e tenderëve është bërë me datë 16.03.2026. Në procesverbalin e hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datë 10.04.2026 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 15.04.2026 jemi drejtuar me Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK me date 16.04.2026 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim me datë 20.04.2026 iu kemi drejtuar OSHP-se me ankesë.

OSHP me datë 10.06.2026 e ka publikuar vendimin lidhur me ankesën tonë ku lëndën e ka

kthyer në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të tenderëve, AK me datë 05.08.2026 e ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së andaj të pakënaqur me këtë vendim me datë 10.08.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me date 13.08.2026 e ka refuzua kërkesën tonë andaj te pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohor po i drejtohem OSHP-se me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së,
2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,
3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,
4. AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe 41 të RRPP-001/2022,
5. AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Neni 1 shumë qartë e thotë se:

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Kjo nuk është respektuar aspak në rastin konkret sepse OE që AK e ka shpallur fitues edhe pse posedon çmimin më të ulët se ne, brenda listës së çmimeve ka ofruar çmime spekuluese që për AK-në do të kushtoj shumë më tepër se sa kontrata jonë, nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga dosja e tenderit dhe përpos kësaj, deklaratën nën betim për anëtarin e dytë të grupit e ka të pavlefshme. Përveç kësaj ky OE nuk ka arritur të sqaroj çmimet e kontestuara nga AK dhe se deklarata e ofruar nga ky OE bie ndesh plotësisht me nenin 41.8 dhe 41.9 të RRPP-001/2022. OE në fjalë nuk ka ofruar as dëshmitë për kontratat e përfunduara ashtu siç ishin kërkuar andaj kjo e forcon akoma më shumë konstatimin se ky OE është plotësisht i papërgjegjshëm.

Nga kjo shihet se AK në mënyrë jo ligjore po tenton të shpërblej me kontratë një OE që realisht është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka ofruar informatat e kërkuara shtesë nga AK ashtu si duhet, nuk ka plotësuar kriterin për referenca të ngjashme deri në vlerën 60% si lider i grupit si dhe deklaratën nën betim për anëtarin e dytë të grupit e ka të pavlefshme. Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e ligjit nga çka do shkaktohet shpenzim i parasë publike në mënyrë jo efikase, jo efektive, jo transparente por edhe jo ekonomike. Për këto mangësi dhe shkeljet e tjera të AK-së do ju njohim edhe në vazhdim.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër faktit që Grupi i OE i shpallur fitues nuk ka ofruar sqarime të mjaftueshme dhe bindëse për çmimet e kontestuara nga AK, edhe pse nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara për përfundim të suksesshëm të kontratave ashtu siç ishin kërkuar në FDT, si dhe për faktin që deklarata nën betim e anëtarit të grupit është e pavlefshme, prapë AK e ka favorizuar dukshëm duke e shpallur atë edhe fitues. Grupi i OE i shpallur fitues posedon çmimin më të ulët se ne por ka mangësi të theksuara në tenderin e tij duke potencuar veçanërisht çmimet spekuluese të pa sqaruara si duhet, mungesën e referencave si dhe deklaratën nën betim të pavlefshme prandaj mos vlerësimi i tenderëve në mënyrë të drejtë dhe favorizimi i këtij Grupi të OE që është shpallur fitues e bënë AK-në shkelëse të plotë të nenit 7 të LPP-së.

Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim edhe me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë dhe të barabartë të tenderuesve.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni thotë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne konsiderojmë se ky nen është shkelur me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht të tenderit që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti posedon mangësi të theksuara në tenderin e tij. Këtë e themi sepse ky Grup i OE ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta të cilat nuk ka arritur të i sqaroj ashtu siç e kërkon ligji dhe rregullorja, nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se lideri ka referenca për **Furnizim me material elektrik** në lartësinë 60% aq sa

kishte kërkuar AK si dhe për faktin që anëtar i dytë i grupit e ka të pavlefshme deklaratën nën betim. Kjo tregon qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së por edhe në kundërshtim të plotë me nenin 65 të LPP-së.

Si mangësi të tenderit të Grupit të OE që AK e ka shpallur fitues janë ato që i theksuam më sipër dhe në vazhdim po i paraqesim më detalisht secilën prej tyre.

I. Mungesa e parë në tenderin e Grupit të OE “Vitech SH.P.K. & AG INSTAL SH.P.K.”

që është i shpallur edhe si fitues është se i njëjti ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta për disa nga pozicionet që edhe vet AK i ka kontestuar dhe se pas kërkesës për sqarime, ku GOE nuk ka arritur të ofroj sqarime dhe dëshmi bindëse se çmimet e tilla janë çmime reale të tregut. Përpos kësaj ky Grup i OE nuk iu ka përmbajtur fare kërkesës së nenit 61 të LPP-së dhe 41 të RRPP-001/2022 për ofrim të sqarimeve lidhur me çmimet e kontestuar andaj sqarimi i tillë nuk mundet të pranohet si i plotë dhe i mirëqenë për çka edhe e bënë tenderuesin në fjalë si të papërgjegjshëm. Shkeljen e nenit 61 të LPP-së dhe shkeljen e nenit 41 të RRPP-001/2022 për mos trajtim si duhet të çmimeve jo normalisht të ulëta nga ana e AK-së por edhe nga ana e GOE të shpallur fitues, do ta elaborojmë tek pretendimi i radhës ku krejt këtë mundëni të e shikoni tek përshkrimi i shkeljes së nenit 61 të LPP-së dhe 41 të RRPP-001/2022 në pikën 4.

II. Mungesa e dytë në tenderin e Grupit të OE “Vitech SH.P.K. & AG INSTAL SH.P.K.”

të shpallur edhe si fitues është ajo se ky tenderues nuk ka arritur ta plotësoj kriterin për posedim të referencave për **Furnizim me material elektrik** deri në vlerën 60% nga lideri i grupit. E themi këtë për faktin se kërkesa ishte decidive që lideri i grupit duhet të posedoj projekte të realizuara për **Furnizim me material elektrik** deri në lartësinë 60% të vlerës 135,000.00€ të cilën ky lider i grupit nuk e ka. Bazuar në informatat që ne kemi për këtë tenderues, del se OE Vitech SH.P.K. nuk e ka asnjë projekt të realizuar për **Furnizim me material elektrik andaj** dhe si i tillë realisht do duhej konsideruar i papërgjegjshëm. Ja si dukej kërkesa e AK-së për këtë kriter:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
		Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës Furnizim me material elektrik, gjate 3 viteve të fundit (nga data e publikimi të Njoftimit për Kontratë), në një vlerë prej jo me pak se 135,000.00 € e në raste të themelimit të grupit, Lideri i grupit duhet të ketë 60% të vlerës të qarkullimit të cekur	Dëshmia 1 Kur furnizimi, shërbimi, puna është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë (Psh Fatura);

OE Vitech SH.P.K. i cili sipas marrëveshjes së konzorciumit dihet se ishte përcaktuar si lider i grupit besojmë se nuk ka asnjë referencë lidhur me natyrën e projekteve të kërkuara andaj realisht duhet të konsiderohet tenderues i papërgjegjshëm. Mos mundësia e dëshmimit se lideri i grupit posedon projekte të realizuara nga natyra e kërkuar: **Furnizim me material**

elektrik, bie ndesh edhe me nenin 69 të LPP-së e cila për pasoj e shtynë AK-në mandej drejt shkëljes së plotë nenit 59 të LPP-së. Për më detalisht ju lutem shikojeni me kujdesë tenderin e Grupit të OE në fjalë dhe projektet e paraqitura nga lideri i gruit.

III. Mungesa e tretë në tenderin e Grupit të OE “Vitech SH.P.K. & AG INSTAL SH.P.K.” të shpallur edhe si fitues është se ky Grup i OE ka paraqitur Deklaratën nën Betim për anëtarin e grupit siç është AG INSTAL SH.P.K. e cila realisht konsiderohet e pavlefshme. Këtë e themi për faktin se ky tenderues në rreshtin e parë të deklaratës nuk e ka vendosur emrin e vet por e ka vendosur emrin e një kompanie tjetër që realisht i bie se deklarata nën betim jepet për dikë tjetër e jo në emër të OE AG INSTAL SH.P.K. për çka e njëjta edhe nuk e ka efektin e plotë juridik që për nga plotësueshmëria juridike posedon vlerën “nul”. Ja si duket ky dokument:

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM 

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: **Vitech SHPK** deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedure të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	AG INSTAL SHPK 
Adresa e plotë:	Rr. Balshaj, PN, Milosheve, Obiliq.
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Gentmir Vershevc
Pozita:	Drejtor Menaxhues
Nënshkrimi:	
Data:	11.03.2026
Vula:	

Bazuar në këtë po shihet se kjo deklaratë nën betim nuk do duhej pranuar si e rregullt dhe rrjedhimisht ky tenderues konsiderohet plotësisht i papërgjegjshëm. Marrë për bazë këtë, ne nuk kemi se si të mos mendojmë që AK ka shkelur plotësisht nenin 65 të LPP-së si dhe ka shkelur kërkesën që vet e ka vendosur në FDT tek pika 6.4 e sajë, kur e ka vlersuar gabimisht

si të përgjegjshëm Grupin e OE që më pas edhe e ka shpallur jo ligjërisht si fitues.

IV. Mungesa e katërt në tenderin e Grupit të OE “Vitech SH.P.K. & AG INSTAL SH.P.K.” të shpallur edhe si fitues është se ky Grup i OE ka paraqitur Deklaratën për themelimin e grupit por që të njëjtën nuk e ka plotësuar ashtu si duhet pasi që tek faqja e tretë e ka fshirë pjesën ku caktohet përfaqësuesi i autorizuar për veprim në emër të grupit. Bazuar në nenin 44.3 të RRPP-001/2022, ky tenderues ka modifikuar formularin standard për themelimin e grupit dhe si i tillë konsiderohet i papërgjegjshëm. Ja si duket marrëveshja e tillë: dhe ja si duket pjesa që ky tenderues e ka fshirë.

Emri i Operatorit Ekonomik (lider)	VITECH SH.P.K.
Emri Mbiemri	Fatmir Cakaj – Drejtor Menaxhues
Data/ Nënshkrimi/ Vula	09.03.2026
Anëtarët e tjerë të grupit:	
Emri i Operatorit Ekonomik (anëtar):	AG INSTAL SH.P.K.
Emri Mbiemri	Gentmir Vershevc - Drejtor Menaxhues
Data/ Nënshkrimi/ Vula	09.03.2026
Shto sipas nevojës	

Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar) _____

Data/Nënshkrimi / Vula _____

VI. Mungesa e pestë në tenderin e Grupit të OE “Vitech SH.P.K. & AG INSTAL SH.P.K.” të shpallur edhe si fitues është se ky OE Vitech ka paraqitur vërtetimin e ATK-së jo për pjesëmarrje në tender por për aplikim për kredi. Ky vërtetim konsiderohet i pavlefshëm çka e bënë tenderuesin të papërgjegjshëm. Ja si duket ky dokument:

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:

Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:

Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:



1001323099

Emri i personit:

Name of Person:

Ime lice:

Vitech SH.P.K.

Numri Identifikues Personal:

Personal Identification Number:

Identifikacioni Lični Broj:

Numri Fiskal:

Fiscal Number:

Fiskalni Broj:

810534166

Komuna:

Municipality:

Opština:

PRISHTINË

Data:

Date:

Datum:

20.02.2026

Arsyeja e lëshimit:

Reasoning:

Razlog izdavanja:

Aplikim për kredi

ka këtë gjendje tatimore në ATK:

has the following tax position with the TAK:

Sipas krejt kësaj del që AK gjatë procesit të vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve, ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së duke bërë vlerësim të pa drejtë, të paligjshëm dhe shumë joprofesional.

4. AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41.8 dhe 41.9 të RRPP-001/2022 pasi që nuk e ka aplikuar drejt dhe si duhet sqarimin e çmimeve jo normalisht të ulëta tek OE që e ka shpallur fitues. Fillimisht po e paraqesim si duken këto dispozita:

41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

- ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

- elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

AK nuk i ka respektuar asnjërën nga dispozitat e mësipërme pasi që përpos se nuk ka pranuar sqarime për çmime e kërkuara sipas nenit 41.8 dhe 41.9, AK nuk e ka pranuar as dëshmi që

mund të konsideroheshin bindëse për qëllimin e kërkuar. Vlen të ceket se AK ka kërkuar sqarime shtesë për disa nga çmimet e ofertuara nga ky Grup i OE por që i njëjti nuk ka arritur të i sqarojë çmimet e tilla ashtu siç e kërkon ligji dhe rregullorja përkatëse. Ja si duket kërkesa e AK-së:

NPL KASTRIOTI SH.A RR:VASHINGTONI 15000 OBILIQ

Dt:10.07.2026

Grup i Operatorëve Ekonomik Vitech Sh.p.k.; AG INSTAL SH.P.K., Rr. Vicianum nr. 210, 10000, PRISHTINË, Kosovë

Nr. i Prokurimit:	NPL KASTRIOTI -26-1034-1-2-1
Nr i brendshëm	

Titulli: Furnizim me materiale elektrik për nevoja të ndërmarrjes-Ri-tender

I/e nderuar Fatmir Cakaj

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “ LPP ”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Duke u bazuar në çmimet e njësisë së kërkesës dhe me çmimet e tregut të marura nga Komisioni i Vlerësimit, ne konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës në pozicionet: 1.1, 1.2, 1.3, 1.25 si dhe pozicioni 3.37 Furnizimi i Kontaktorit CN-1000A ku çmimi i ofertuar është shumë më i lirë se sa dy kontaktore me ampera më të vogël.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, duke filluar me çmimet e furnizimit dhe shpenzimet tjera deri tek arritja e çmimit të ofertuar në artikujt e cekur si në vijim:

Nr.ren	Përshkrimi i Produkteve	Njësia	Sasia
1.1	Furnizimi i trupit Led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC, 50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia: 50W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficienca: min 90 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite, (në çmim përfshihet edhe gypi i zinguar Ø40 – 60 me gjatësi 7-10 cm për montimin e trupit ndriçues si dhe dy lidhëse (kleme) me dimensione 3x1.5mm për lidhjen e trupit ndriçues).	copë	1

1.2	Furnizimii i trupit Led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC,50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia:100W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficienca: min 90 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite, (në çmim përfshihet edhe gypi i zinguar Ø40 – 60 me gjatësi 7-10 cm për montimin e trupit ndriçues si dhe dy lidhëse (kleme) me dimensione 3x1.5mm për lidhjen e trupit ndriçues).	copë	1
1.3	Furnizimi i trupit Led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC,50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia:150W-1 Frequency Range 50 – 60 HZ Eficienca: min 90 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite, (në çmim përfshihet edhe gypi i zinguar Ø40 – 60 me gjatësi 7-10 cm për montimin e trupit ndriçues si dhe dy lidhëse (kleme) me dimensione 3x1.5mm për lidhjen e trupit ndriçues).	copë	1
1.25	Furnizimi i AS me shtjellim prej 100-160A. Çmim mesatar.	copë	1
3.37	Furnizimi I Kontaktorit CN-1000A	copë	1

Sqarim: Sipas komisionit të vlerësimit, çmimet e cekura më lartë në ofertën Tuaj, janë shumë apo jo-normalisht të ulëta. Oferta e Juaj bie ndeshë me Rregullat për tenderët me çmime jo-normalisht të ulët.

Kërkojmë sqarime Komfor Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët, B57 Neni 4 pika 4.4.4, citojmë: "origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara", pra duhet të na ofrohen dëshmi / asrëtime bindëse, si keni planifikuar ti realizoni punimet ne pozicionet e parapara.

Nisur nga kjo dhe nga ajo që e kërkon ligji dhe rregullorja, OE janë të detyruar çdo herë që sqarimin e çmimeve jo normalisht të ulëta ta bëjnë sipas rregulloreve në fuqi duke ofruar fakte bindëse se çmimet e tilla janë çmime reale të tregut. Kjo nuk ka ndodhur sepse Grupi i OE ka ofruar një deklaratë por jo edhe fakte dhe argumente të vlefshme siç e kërkon ligji dhe rregullorja. Ja si duket përgjigja e tyre:

Grupi i Operatorëve Ekonomikë VITECH SH.P.K & AG INSTAL SH.P.K.

Lënda: Sqarim lidhur me çmimet e ofertuara

I nderuar Autoritet Kontraktues,

Në përgjigje të kërkesës suaj për sqarim lidhur me çmimet e ofertuara në këtë procedurë të prokurimit, ju njoftojmë se oferta e GOE VITECH SH.P.K & AG INSTAL SH.P.K. është përgatitur pas një analize të detajuar të kostove dhe në përputhje me strategjinë tonë komerciale. Të gjitha çmimet e ofertuara janë reale, të zbatueshme dhe nuk ndikojnë në aftësinë tonë për realizimin e kontratës sipas specifikimeve teknike, afateve dhe kushteve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Lidhur me pozicionet e ndriçimit LED, çmimet tona të furnizimit janë si më poshtë:

* Trupi LED 50W – 9.00 €, ndërsa çmimi i ofertuar është 13.00 €;

* Trupi LED 100W – 15.00 €, ndërsa çmimi i ofertuar është 18.00 €;

* Trupi LED 150W – 18.75 €, ndërsa çmimi i ofertuar është 22.00 €.

Po ashtu, për pozicionin 3.37, çmimi ynë i furnizimit është 31.00 €, ndërsa çmimi i ofertuar është 35.00 €. Pozicioni 3.37, për të cilin oferta jonë paraqet një çmim më të ulët, praktikisht është rrallë i përdorshëm në nevojat reale brenda Komunës së Obiliqit. Bazuar në përvojën tonë shumëvjeçare si kompani që ka mirëmbajtur një pjesë të konsiderueshme të objekteve shkollore dhe komunale në këtë komunë, kemi hasur vetëm në një rast të vetëm përdorimin e një kontaktori 400A.

Nga ana tjetër, si nënkontraktor në projektet e KEK-ut kemi montuar kontaktorë me kapacitet 1000A e më lart, të cilët përdoren në instalime industriale dhe jo në objektet komunale të administruara nga NPL "Kastrioti".

Prandaj, pozicioni 3.37 nuk përfaqëson një artikull me përdorim të zakonshëm apo të domosdoshëm për nevojat e NPL "Kastrioti". Për rrjedhojë, fakti që oferta jonë për këtë artikull është me çmim më të ulët nuk ndikon në realizimin e kontratës dhe nuk mund të shërbejë si bazë për të vënë në dyshim përgjegjshmërinë e ofertës sonë, aq më tepër kur për të gjitha pozicionet e tjera çmimet janë reale, të argumentuara dhe të mbështetura me dokumentacion përkatës.

Nga sa u tha më sipër rezultojnë se për këto artikuj kompania jonë realizon fitim normal, i cili mbulon koston e furnizimit, transportit, logjistikës, garancisë dhe të gjitha detyrimet kontraktuale.

	Sa i përket pozicionit 1.25 – AS 100–160A, çmimi ynë i furnizimit është 10.00 € për njësi, ndërsa çmimi i ofertuar është 1.00 € për njësi. Ky çmim është vendosur me vetëdije si pjesë e strategjisë sonë komerciale për të paraqitur një ofertë sa më konkurruese dhe nuk është rezultat i ndonjë gabimi gjatë përgatitjes së ofertës. Theksojmë se ky është i vetmi artikull në të gjithë ofertën tonë që është ofertuar nën koston e furnizimit. Të gjithë artikujt e tjerë janë ofertuar mbi koston e furnizimit dhe gjenerojnë marzh normal fitimi, gjë që dëshmon se oferta jonë, e marrë në tërësi, është ekonomikisht e qëndrueshme dhe plotësisht e realizueshme. Edhe pse ky artikull është ofertuar nën koston e furnizimit, kjo nuk ndikon në realizimin e kontratës, pasi analiza financiare e ofertës sonë tregon se vetëm nga pozicionet e tjera realizohet një marzh fitimi prej 414,16€ për njësi (1217,73 – 803,21 = 414,16€), shumë e cila është plotësisht e mjaftueshme për të mbuluar diferencën e krijuar nga ky çmim strategjik. Për rrjedhojë, oferta jonë mbetet ekonomikisht e qëndrueshme, fitimprurëse dhe plotësisht e realizueshme. Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se zyrat dhe depoja e anëtarit që do të bëjë dorëzimin e mallit, AG INSTAL SH.P.K. ndodhen vetëm rreth 3.5 km nga depot e NPL “Kastrioti”, gjë që na mundëson uljen e kostove të transportit, logjistikës dhe kohës së furnizimit. Kjo afërsi ndikon drejtpërdrejt në optimizimin e kostove operative dhe na mundëson të ofrojmë çmime më konkurruese pa cenuar cilësinë e mallrave apo realizimin e kontratës. Për të mbështetur sqarimet tona, bashkëngjitur po dorëzojmë Marrëveshjen e Furnizimit dhe Aneksin nr. 1, të cilat dëshmojnë marrëdhënien tonë kontraktuale me furnizuesin dhe aftësinë tonë reale për të furnizuar mallrat sipas çmimeve të ofertuara. Kompania jonë ka përvojë shumëvjeçare në realizimin e kontratave të ngjashme dhe garanton se, në rast të shpalljes fitues, do të furnizojë të gjithë artikujt sipas specifikimeve teknike, afateve dhe çmimeve të ofertuara, pa asnjë kërkesë për ndryshim të kushteve kontraktuale. Në përfundim, ritheksojmë se oferta e VITECH & AG INSTAL SH.P.K. është plotësisht e realizueshme, ekonomikisht e qëndrueshme dhe nuk paraqet asnjë rrezik për ekzekutimin e kontratës. Përkundrazi, ajo siguron përdorim efikas të fondeve publike, duke ofruar mallra në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me çmime konkurruese. Po ashtu, rikujtojmë se edhe në Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0264 është theksuar rëndësia e respektimit të parimit të economicitetit dhe përdorimit efikas të parasë publike. Në këtë frymë, oferta jonë paraqet alternativën ekonomikisht më të favorshme për Autoritetin Kontraktues, duke mundësuar kursim të mjeteve publike pa asnjë kompromis në cilësi, specifikimet teknike apo realizimin e kontratës.	
--	--	--

Për më tepër, çmimi strategjik është aplikuar vetëm për një pozicion të vetëm, ndërsa të gjitha pozicionet e tjera janë ofertuar mbi koston e furnizimit. Për këtë arsye, oferta duhet të vlerësohet në tërësinë e saj dhe jo mbi bazën e një artikulli të vetëm, pasi analiza ekonomike dëshmon qartë se kontrata është plotësisht e realizueshme dhe financiarisht e qëndrueshme.

Për këto arsye, kërkojmë që sqarimet dhe dokumentacioni i bashkëngjitur të merren në konsideratë dhe oferta jonë të vlerësohet si e përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke respektuar vendimin e OSHP-së për parimin e ekonomicitetit ku dihet se oferta jonë është më ekonomike dhe të gjithave.

Për fund përpos kontratës për furnizim dhe aneksit 1, bashkëngjitur gjeni dhe një ofertë të pranuar e cila vërteton saktësinë dhe marzhëm e fitimit për ne si furnizues.

Me respekt,

VITECH SH.P.K & AG INSTAL



Përpos këtyre ky Grup i OE ka ofruar edhe disa marrëveshje por që nuk janë të tipit faktues për qëllimin për të cilin ishin kërkuar. Bazuar në këtë deklaratë, shihet se OE në fjalë nuk ka ofruar asnjë informatë apo sqarim bindës që tenderuesi në fjalë mundet të ju përmbahet çmimeve të tilla. Vlen të përmendet edhe një element me rëndësi që AK nuk ka kërkuar fare sqarim për shumë nga çmimet tjera që realisht janë edhe më shumë jo normalisht të ulëta. Nisur nga kjo dhe nisur nga forma e arsytimit të ofruar nga Grupi i OE, konstatojmë se AK nuk e ka trajtuar tenderin në fjalë ashtu si duhet dhe për pasojë ka ardhur edhe deri tek shpallja si fitues e një tenderuesi me çmime spekuluese dhe mashtruese. Kontrata me çmime të tilla realisht AK-së do i kushtonte shumë më shtrenjtë dhe se ka edhe rrezik që një pjesë e konsiderueshme e artikujve të mos kenë mundësi të liferoheshin fare.

Pas analizimit të çmimeve të ofruara nga ky Grup i OE, shihet se pothuajse shumica e çmimeve të ofertuara janë çmime jo normalisht të ulëta. Si të tilla ne po i potencojmë disa nga to ku i kërkojmë edhe ekspertit të OSHP-së që të merr mundimin dhe të hulumtoj tregun dhe të bindet edhe vet që çmimet e tilla janë jo normalisht të ulëta.

Si çmime jo normalisht të ulëta përpos atyre që edhe vet AK i ka kontestuar, konsiderojmë se janë edhe çmimet nga pozicioni: 1.1, 1.2, 1.3, 1.25, 1.26, 1.27, 1.29, 2.6, 2.7, 2.9, 2.12, 3.26, 3.27, 3.28, 3.29, 3.30, 3.31, 3.32, 3.33, 3.34, 3.35, 3.36, 3.37, 3.39, 3.40, 3.41, 3.42, 3.43, 3.44, 3.45, etj. Pra të gjitha çmimet e cekura më sipër shihet qartë se janë çmime jo normalisht të ulëta ku disa nga to janë deri në 50 herë më të ulëta se çmimet e tregut.

Nisur nga krejt kjo dhe pas analizave dhe hulumtimit të tregut që ne kemi bërë, po shihet qartë se AK ka shkelur plotësisht nenin 61 të LPP-së dhe nen 41 të RRPP-001/2022, me rastin e përzgjedhjes së OE që edhe e ka shpallur fitues edhe pse i njëjti është i

papërgjegjshëm pasi që shumicën e çmimeve i ka jo normalisht të ulëta dhe se nuk ka arritur të japë sqarime bindëse as për ato pak çmime që AK ia ka kontestuar dhe i kishte kërkuar sqarime.

5. AK ka shkelur nenit 65 të LPP-së pasi që tenderuesit të cilin edhe e ka shpallur fitues ja ka pranuar deklaratën nën betim për anëtarin e dytë të grupit edhe pse deklarata e tillë nuk e ka efektin e plotë juridik për tu pranuar si deklaratë e pranueshme. Pranimi i një deklarate të tillë e shtynë AK-në në shkelje të plotë të nenit 65 të LPP-së dhe shkelje të plotë edhe të kërkesës së aplikuar tek pika 6.4 e FDT-së. Për këtë mangësi kemi dhënë sqarimin e plotë tek pika 3 e pretendimit ku tek mangësia e III e GOE në fjalë kemi elaboruar dhe kemi paraqitur edhe vizualisht pamjen e deklaratës në fjalë. Vlen të thuhet edhe kjo se në faqen e OSHP-së ka shumë vendime të publikuara që për mangësi të tillë dhe të ngjashme si dhe mos plotësim të deklaratës nën betim ashtu si duhet, OE të ndryshëm janë penalizuar duke u cilësuar si të papërgjegjshëm. Nëse eksperti i OSHP-së ka nevojë, mundet të na e kërkoj dhe ne ja dërgojmë dhe se arsye e mos paraqitjes së tyre tani në këtë ankesë, është fakti që nuk duam të shkelim privatësinë e kompanive të penalizuara për gabime të tilla duke i bërë edhe pjesë të lëndës dhe të këtij kontesti.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “Item EL SH.P.K.” lidhur me tenderin “**Furnizim me materiale elektrik për nevoja të ndërmarrjes-Ri-tender**”.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK – **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.** dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në detyrimet e LPP-së, e që realisht më pas do duhej që **Fitues** të shpallej OE “**Item EL SH.P.K.**”.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Template per Dosja e Tenderit -shqip
-  3 Paramasa-shqip-Furnizim me material elektrik për nevoja të Ndermarrjes-Ri-tender
-  4 Proces verbali i hapjes se Tenderve
-  5 Njoftim për vendimin e AK 10.04.2026
-  6 Kërkesë për rishqyrtim - Item EL SHPK - 15.04.2026

-  7 Pergjigje ne kerkesen e OE Item El sh.p.k
-  8 ANKESA - OSHP - Item EL SHPK - 26.04.2026
-  9 Vendimi I OSHP 2026 0269
-  10 Njoftim për vendimin e AK-Ri-vleresim- 05.08.2026
-  11 KERKESE PER RISHQYRTIM - Item EL SHPK - 10.08.2026
-  12 Përgjigje në Kërkesën për rishqyrtim-Item el 13.08.2026
-  13 Lista e cmimeve e GOE Vintech-AG INSTAL
-  14 Deklarata nen Betim e AG INSTAL SHPK
-  15 Referencat e OE VINTECH SHPK - 2007 - 2026
-  16 Dek. themelimit te grupit
-  17 Ver. i ATK 20.02.2026

Vërejtje: Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet e gjeni të bashkangjitur ndërsa ofertën tonë e gjeni në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në e-Prokurimit!